



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/639  
Datë: 19/11/2020

Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me datë 19.11.2020 lëshon këtë

**N J O F T I M**

***Për sqarimin e pikës (13) të konkursit për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2020/2021, me nr. të prot.: 2/262, të datës 02.11.2020***

1. Në konkursin për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2020/2021, me nr. të prot.: 2/262, të datës 02.11.2020, në pikën (13) është përcaktuar kriteri si në vijim: *“Kandidatët i nënshtrohen parimit të ndalimit të konfliktit të interesit sipas legjislacionit në fuqi, Kodit të Etikës dhe Udhëzuesit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit të Këshillit të Etikës në UP. Në mënyrë të veçantë, do të konstatohet që ekziston konflikti i interesit, nëse kandidati/kandidatja ka në lidhje të drejtë gjaku një apo më shumë anëtarë të personelit akademik në njësinë akademike përkatëse.”*
2. Pika (13) e konkursit, e cituar më lart, i obligon njësitë akademike dhe mësimdhënësit që, lidhur me zbatimin e konkursit për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës, të kujdesen për:
  - a) *Zbatimin e legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit në procesin vendimmarrës për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës, duke shmangur konfliktin e interesit sa u përket komisioneve dhe trupave të tjerë vendimmarrës lidhur me konkursin;*
  - b) *Zbatimin e parimeve të Kodit të Etikës që e përcaktojnë detyrimin për të vepruar në interesin më të mirë të Universitetit dhe të shoqërisë, në veçanti për shmangien e konfliktit të interesit përkitazi me pjesëmarrjen në komisione dhe trupa të tjerë vendimmarrës në procesin e pranimit të studentëve në studimet e doktoratës.*
3. Sipas pikës (13) të konkursit, lidhur me themelimin e komisioneve për zbatimin e konkursit dhe vendimmarrjen për pranimin e studentëve, në mënyrë të veçantë të konstatohet se ka konflikt interesi në rastet kur ndonjë anëtar i personelit akademik brenda njësisë akademike përkatëse ka lidhje të drejtë gjaku me kandidatin/kandidaten që ka aplikuar në konkursin për pranim në studimet e doktoratës brenda së njëjtës njësi akademike.

4. Pika (13) e konkursit me nr. të prot.: 2/262, të datës 02.11.2020, nuk ia ka ndaluar asnjë kandidati aplikimin për pranimit në studimet e doktoratës për vitin akademik 2020/2021.
5. Njësitë akademike e vazhdojnë procesin e filluar sipas kriterëve të përcaktuara në konkursin e datës 02.11.2020 me nr. të prot.: 2/262.
6. Komisionet pranuese për zbatimin e konkursit mbesin të pandryshuara.
7. Procesi i pranimit të studentëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2020/2021 vazhdohet sipas afateve si në vijim:
  - a) **Provimi pranues** mbahet më **23.11.2020** duke filluar nga ora 12.00. Informata shtesë për sallat e mbajtjes së provimit pranues do të publikohen më vonë në webfaqen e fakultetit përkatës.
  - b) **Intervista** me kandidatë do të mbahet më **30.11.2020** dhe **01.12.2020** duke filluar nga ora 10.00.
  - c) **Rezultati preliminar** do të shpallet më **02.12.2020 deri në orën 15:30**.
  - d) Ankesat e kandidatëve të papranuar do të pranohen më **03.12.2020** dhe **04.12.2020 deri në orën 15:30**. Vendimi përfundimtar rreth ankesës merret nga Komisioni për Studime të Doktoratës i njësisë akademike përkatëse më së largu deri më **09.12.2020**.
  - e) **Rezultati përfundimtar**: Senati i Universitetit, me propozimin e njësisë akademike dhe pas shqyrtimit në Këshillin Qendror të Studimeve të Doktoratës, e merr vendimin përfundimtar për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës. Emrat e kandidatëve të pranuar, me të gjitha të dhënat e kriterëve të përzgjedhjes, shpallen publikisht në webfaqen e njësisë akademike dhe në webfaqen e Universitetit.
  - f) **Data e regjistrimit** të kandidatëve të pranuar do të publikohet pas vendimit përfundimtar të Senatit.

Njoftimit t'u shpërndahet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Menaxhmentit të UP-së;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. Dekanëve të fakulteteve;
5. Sekretarëve të fakulteteve dhe
6. Zyrtarit ligjor të UP-së.

